The pandemic period is bringing a radical transformation in the way people search for and buy the products and acquire the services they need. Consumer behavior in the tourism sector in the purchase of tourism services is influenced by economic, socio-demographic, cultural, psychological factors, etc.; factors that suffered; since the beginning of the COVID 19 Pandemic. This study attempts to highlight the impact that the pandemic has had on the customers of the tourism sector since January 2020. The pandemic affects the functionality of many industries by affecting almost every sector of the global economy, furthermore it inevitably means that some sectors in particular will have to be resized and reshaped, in the concept of building such a business structure that will be able to withstand such (destructive explosions) in the economic environment as the tourism sector, entertainment industry, travel, etc. by facing radical changes in consumer behavior in purchasing these services. This paper aims to analyze changes in consumer behavior in the Albania's tourism sector during unusual situations such as the outburst of a pandemic. The data were mainly collected in the city of Tirana and Durrës. The data were obtained through surveys and have been processed through statistical and computer methods, which show that the change in consumer behavior has been experienced by tour operators, accommodation, transport, etc. operating in our country after the period of global pandemic, thus seeking new ways of adapting to the created situation.

Keywords: *Tourism sector. Consumer Behavior, Factor Influence, Pandemic, Covid 19*

Kosovo's EU perspective: realistic or not?

Leandrit Mehmeti, University of South Australia

leandrit.mehmeti@unisa.edu.au

Abstract

Kosovo's EU perspective appears real, at least in EU and Kosovo's Government official discourse. However, Kosovo's position is unique. Its contestation of political status in international relations makes it unclear as to whether Kosovo's EU perspective will ever materialize with a membership. Different factors are linked to such position and perspective. The finalisation of the EU facilitated dialogue between Kosovo and Serbia with the aim of normalizing their relations, geopolitical rationales, as well as the satisfactory performance of state institutions in democracy and good governance remain the main factors to clarify Kosovo's EU integration perspective. This paper argues that further development of democratization, which ensures an effective governance for the people and strengthens the potential for economic stability and growth, creates more potential to advance the integration perspective rather than the dialogue or geopolitical rationales. However, this paper acknowledges that the last-mentioned factors are important and may end up being the factors that determine the EU membership.

The discussion focuses on democratization and normalization of relations as well as how they are linked to the EU integration perspective.

Keyword: *EU, democratization, integration perspective, Kosovo, Serbia.*

Road Infrastructure as a Financial Asset with an Impact on Albania's EU Integration

Arch. Enea Stavre

Arkvizion, Tiranë, Albania

Email: eneastavre1@gmail.com

Abstract

Road infrastructure is considered as a gateway to economic development with an indirect impact on Albania's EU integration. Albania has invested in road infrastructure - creating opportunities for the development of the country - but our country still ranks as a developing country in terms of road infrastructure. If we refer to the public expenditures that have been addressed to the road infrastructure in the country, we conclude that the costs of road construction have been high by not meeting the quality and deadlines. Referring to the design standards in Albania, problems are identified in the design and implementation compared to the countries of the region. This paper aims to list some problems of road infrastructure in Albania, and explains why road infrastructure in Albania needs to be improved. Even though this study is mainly descriptive, the author has also interviewed experts mainly in the fields of urban planning, civil engineering and architecture in order to reach and argument its conclusions. The conclusions of this paper will serve as a guide for risk management and improvement of road infrastructure according to European standards. Policymakers concerned with the development of the country should pay attention to the road investment because the feedback from this investment is direct and indirect for the development and integration of the country in the EU.

Keywords: *EU integration, road construction, infrastructure, development*

Sfidat në fushën e arsimit ne Shqiperi ne kuader te perocesit te integrimit evropian

Dr. Lindita Kiri (Kurshumi)

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Shqiperi

E-mail : linditakiri@yahoo.com

Abstrakt

BE-ja ka rol mbështetës në politikat e arsimit dhe integrimit .Shtetet anëtare janë përgjegjëse për sistemet e tyre të arsimit duke bashkepunuar brenda kornizës së BE-së me qëllim të arritjes së qëllimeve të përbashkëta . Qasja e BE-së pranon që arsimi cilësor ne te gjitha nivelet janë faktor themelor për suksesin e BE-së. Theks i vecante vihet në mësimin gjatë gjithë jetës, duke e konsideruar atë si prioritet të lartë në një botë kur ndryshimet janë shumë të shpejta. Mësimi gjatë gjithë jetës është i rëndësisë themelore për punësimin dhe integrimin e njerezve ne shoqeri.

Objektivat e BE-së në politikat e arsimit janë: Bërja realitet e mësimit gjatë gjithë jetës; Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit ; Forcimi i kreativitetit dhe inovacionit etj. Në aspekt të politikës së zgjerimit ne fushen e arsimit kerkohet te zhvillohet një ambient bashkëpunues në mes të shteteve.anetare që të arrihen synimet e përbashkëta. Hipoteza e pergjithshme e punimit eshte: Cilat jane sfidat ne fushen e arsimit ne Shqiperi ne kuader te procesit te integrimit Evropian ? Metodatat e punimit jane ato te hulumtimit, krahasimit dhe analizes. Rezultatet e punimit bazohen ne kornizen e politikave ne fushen e arsimit dhe strukturen e sistemit te arsimit ne Shqiperi.

Fjalë kyc: *Sfida , arsim, Bashkimi Evropian, sistem, politika, gjithperfshirje.*

Increasing the exports of Western Balkan SMEs to the EU market through innovative activities: Empirical insights from Kosovo

Dr. Gezim Jusufi

gezimi.gjilan@gmail.com

Prof.Ass. Dr. Vehbi Ramaj

Msc. Artan Ramaj

Abstract

This paper examines export growth through innovations of manufacturing SMEs in the Western Balkans, with a particular emphasis on Kosovo SMEs. Kosovo SMEs must be competitive in the EU market in order to reap the benefits of the SAA (Stabilization and Association Agreement). To be competitive, they need to develop innovative activities. Through innovative activities they will be able to increase their exports and thus benefit from free trade with the EU. The sample of analyzed SMEs is composed of 100 Kosovo exporting SMEs that export to the EU market. The paper fills a literature gap by constructing a measure of innovation types in Western Balkans SMEs, especially in Kosovo SMEs. Results of logic model show that Product innovation, Marketing innovation and Organizational innovation have a positive relationship with the dependent variable which represents the increase in the export of these SMEs. Whereas, only the Marketing Innovation variable is significant in this model. The results indicate that Ownership structure and the Education level of employees have a positive relationship with export growth. However, the export experience of these SMEs has no positive relationship with the increase in exports, because Kosovo manufacturing SMEs have no more than 20 years of export experience.

Keywords: *EU, SMEs, innovations, Western Balkans, logic model, export.*

Aspektet ekonomike dhe financiare në procesin e integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian

Prof. Florije Miftari, Kolegji AAB, Prishtinë

florije.miftri@universitetiaab.com

Prof. ass. Nakije Kida, Kolegji AAB, Prishtinë

nakije.kida@universitetiaab.com

Abstrakt

Procesi i integritit në Bashkimi Evropian edhe pse i dëshirueshëm, është treguar si një rrugë e vështirë dhe komplekse për shumicën e vendeve, posaçërisht për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku shumica e tyre këtë proces e kanë filluar që para 20-vjetësh, por që akoma nuk kanë arritur të anëtarësohen. Bashimi Evropian mund të ndihmojë vendet e Ballkanit në zhvillimin ekonomik dhe social. Por, efikasiteti i institucioneve, qytetarët dhe shoqëria e bazuar në respektimin e ligjit dhe të drejtave dhe lirive individuale janë ata të cilët kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale. Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizohen përfitimet ekonomike dhe financiare që mund të kenë vendet e Ballkanit Perëndimor si në periudhën e paraanëtarësimit ashtu edhe në atë të anëtarësimit në Bashimin Evropian. Për të arritur qëllimin e hulumtimit shfytëzohet metoda përshkruese dhe krahasuese, bazuar në të dhënat dhe informatat nga aktet rregullative për anaëtarësim në Bashkimin Evropian dhe nga të dhënat e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Pavarësisht, suksesit dhe kohëzgjatjes së procesit të integritit, me vete faktin e aplikimit të kriterëve politike, juridike, ekonomike dhe financiare që rrjedhin nga marrëveshtja e Maastrichtit dhe e Kopenhagës, vendet përfitojnë pasiqë krijojnë kushte juridike dhe institucionale para së gjithash për sundimin e ligjit, lirive dhe të drejtave të individit, krijojnë ambient dhe mundësi për përfitime ekonomike, tregtare dhe financiare.

Fjalë kyç: *Bashkimi Evropian, integritet, Ballkani Perëndimor, ekonomi, financa.*

Cilësia e arsimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, reformat dhe sfidat (Rast studimi: Kosova)

Prof.dr.Xheladin Murati

Universiteti i Tetovës, Tetovë. Email: xheladinmurati@yahoo.com

PhD.Can. Besjana Rexhepi

Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan. Email: besjana.rexhepi@uni-gjilan.net

Mr.sc. Mevlyde Syla

Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan. Email: meli.haqifi@uni-gjilan.net

Abstrakt

Cilësia në arsim është një çështje madhore e arsimit. Ajo jo vetëm që është çështje komplekse, po aq është edhe çështje relative mbase ajo duhet të matet me saktësi dhe objektivitet. Meqë është fenomen fluid, aty me ose pa dëshirë përballemi me mangësi. Cilësia është e kushtëzuar edhe nga reformat në arsim. Viteve të fundit, arsimi në Kosovë ka kaluar në disa procese reformimi, që përfshinë të gjitha segmentet dhe nivelet e sistemit arsimor si: zbatimin e kurrikulave, organizimin dhe vlerësimin e të nxënësve, ku të gjitha këto pasqyrojnë politikat dhe strategjitë e zhvillimeve arsimore për të ardhmën. Mbeten sfida të shumta me të cilat vendi ynë po ballafaqohet, si: përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, aplikimi i standardeve evropiane, mungesa e infrastrukturës shkollore dhe përshtatshmëria e materialeve mësimore. Një kontribut i këtij studimi është identifikimi i shkaktarëve që kanë sjell rënien e cilësisë në arsim, paraqitjen e efektit reformë dhe sfidat e saj në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Punimi është i karakterit sasior dhe deskriptiv, pjesë e së cilit është dhe një anketë e realizuar online me 300 mësimdhënësve të qyteteve të ndryshme të Kosovës, me të dhënat e llogaritura në programin SPSS dhe Excel.

Fjalë kyç: *sistem arsimor, cilësi, reformë, sfida, standard, vlerësim.*

Paradigmat mbi procesin e *integritit* dhe funksionimi i mekanizmit të *kushtëzimit demokratik* (Rasti i Shqipërisë)

Erjon Dervishi, PhD.

UniPress Media Group, Tiranë
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
dervishierjon88@gmail.com

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është që të nxjerrë në pah kritikën që i bëhen procesit të Integritit në Bashkimin Europian, se ky proces e ndihmon demokratizimin në rastin e Shqipërisë. Do të argumentojmë se shpesh mënyra se si është konceptuar procesi i integritit dhe se si përdoret nga aktorët lokal, jo vetëm që nuk e ndihmon demokratizimin por e pengon atë. Kjo është nxjerrë në dukje, duke u bazuar te qasja kryesore në fushën e demokratizimit. Duke u përqëndruar pothuajse tërësisht te konsolidimi i institucioneve demokratike, anashkalohet legjitimiteti i elitës dhe mungesa e debatit politik. Pra, një nga argumentat kryesor është se: pavarësisht specifikave, këto qasje e anashkalojnë apo e neglizhojnë politikën, debatin politik si një kategori analitike në procesin e demokratizimit. Vetë mekanizmi i kushtëzimit demokratik nuk është provuar efikasë përball qeverisjes "problematike", si Shqipëria. Kjo rrjedh si pasojë e disa shkaqeve, ku më kryesorja është priorizimi i rezultatit përkundër procesit. Bashkimi Europian pret dhe këmbëngul në arritjen e rezultatit, sesa procesit se si arrihet te ky rezultat. Partitë politike, Institucionet që kanë prioritet integritin dhe shoqëria civile e përfaqësuar nga organizatat joqeveritare është një nga kritikën e paraqitura si dështim, si pasojë e procesit të integritit duke u bazuar te politikën dhe strukturat e tyre. Punimi mbështetet në analizën dhe kërkimin shkencor që vetë autori ka zhvilluar gjatë këtyre muajve të fundit, mbi funksionimin e organizatave civile dhe atyre organizatave me karakter ndërkombëtar. Burimet primare janë marrë nga një korrespondencë e ngjeshur me zyrtarë dhe ekspertë të funksionimit dhe financimit të shoqërive civile në Bruksel dhe në Parlamentin Europian.

Fjalë kyçe: *Bashkimi Europian, integritim europian, shoqëri civile, demokraci shqiptare, donacione.*

Përafrimi i legjislacionit për raportim financiar në Kosovë me "*Acquis Communautaire*" të Bashkimit Evropian

Ylber Prekazi ylber.prekazi@aab-edu.net

Kolegji AAB (Kosovë); dhe Universiteti i EJT (Maqedoni)

Albana Pasjaqa albana.pasjaqa@aab-edu.net

Kolegji AAB, Kosovë

Abstrakt

Procesi i integritetit evropian paraqet një objektiv gjeostrategjik për shumë vendeve që aspirojnë anëtarësimin në shtëpinë e madhe evropiane siç është Bashkimi Evropian, dhe ky objektiv qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme të vendeve përkatëse. Por, dihet se rruga e përafrimit të anëtarësimit është mjaft e gjatë dhe me kërkesa të shumta e të ndryshme, përfshirë këtu edhe harmonizimin e legjislacionit përkatës në shumicën e fushave me atë të BE-së. Gjatë procesit të ndërmarrjes së reformave në kuadrin ligjor dhe përpjekjeve që bëhen për përafrimin me "*acquis*" është e rëndësishme që të identifikohen mangësitë dhe të trajtohen si duhet ato mangësi nga e kaluara me ndryshimet e ligjeve përkatëse në të ardhmen. Harmonizimi i ligjeve edhe nga fusha e kontabilitetit, tatimeve dhe raportimit financiar është një domsdoshmëri e vendeve aspiruese dhe këtë angazhim duhet ta bëjnë gjatë rrugës për anëtarësim. Kështu, si çdo vend tjetër edhe Kosova ka detyrimin jo vetëm ta harmonizojë legjislacionin e fushës së raportimit financiar me "*Acquis Communautaire*", por edhe të sigurojë zbatimin e saj. Në kuadër të kësaj, ndër objektivat kryesore nga institucionet përkatëse duhet të jetë edhe rritja dhe përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar nga shoqëritë tregtare. Në shumë projekte që janë realizuar deri tani nga institucionet ndërkombëtare, është nënvizuar se është shumë e rëndësishme që mangësitë rreth pajtueshmërisë me "*acquis*" të identifikohen dhe adresohen në mënyrën e duhur duke ndryshuar legjislacionin përkatës për raportim financiar nga ana e shoqërive tregtare në Kosovë.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë gjendjen e legjislacionit që i takon fushës së kontabilitetit, raportimit financiar dhe auditimit në Republikën e Kosovës si dhe, harmonizimi i tyre me "*acquis communautaire*" të BE-së. Për realizimin e këtij punimi do të përdoret kryesisht metoda e analizës dhe metoda krahasuese. Po ashtu metodat statistikore dhe grafike do të përdoret për të demonstruar gjetjet nga ky hulumtim.

Fjalë kyç: Raportim financiar, kontabilitet, auditim, kornizë ligjore, "*Acquis Communautaire*", Kosova.

Impakti i liberalizimit të vizave në kërkesat për azil nga Ballkani Perëndimor drejt BE-së

PhD Cand. Avni Rudaku

Universiteti Publik "Hasan Prishtina"

email: rudakuavni@gmail.com

Abstrakt

Pas liberalizimit të vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor për në shtetet e Zonës Shengen të Bashkimit Evropian (BE), si dhe për shtetet si Ukraina dhe Gjeorgjia, numri i azilkërkuesve nga këto vende, është rritur fill pas këtij procesi. Qëllimi i këtij hulumtimi është të krahasuarit e numrit të aplikantëve për azil në vendet e destinacionit evropian menjëherë pas liberalizimit të vizave dhe efektet e këtyre statistikave në vendimet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për kosovarët. Metodat e ndjekura për këtë hulumtim, do të jenë të bazuara në krahasimin e të dhënave sekondare nga EUROSTAT-i, raportet e ndryshme të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, si dhe krahasimi i tyre edhe me të dhënat e azilkërkuesve kosovarë gjatë tremujorit të fundit 2014 dhe tremujorit të vitit 2015, për efektet e rritjes së kërkesave për azil drejt BE-së nga kosovarët, edhe pa liberalizim vizash për ta. Gjetjet tona tregojnë se menjëherë pas liberalizimit të vizave, është rritur numri i aplikimeve për azil nga vendet si Serbia, Maqedonia e Veriut, e sidomos Shqipëria, por edhe nga vendet si Ukraina dhe Gjeorgjia, drejt BE-së. Në anën tjetër, edhe pa liberalizim vizash, është arritur shifra më e lartë pas luftës në Kosovë, e numrit të emigrantëve të parregullt drejt vendeve të BE-së, duke kërkuar mbrojtje ndërkombëtare për azil, edhe pse shumica e tyre kanë theksuar motivin ekonomik. Përfundimi është se liberalizimi i vizave, si dhe mungesa e liberalizimit të vizave apo izolimi, kanë efekte në rritjen e aplikimeve për azil, ndërsa pas një kohe të shkurtër pas liberalizimit të vizave, sërish ka ulje të numrit të rasteve për azil, sidomos për shkak të rritjes së informatave dhe njohjes me realitetin e rregullimit të dokumentacionit për lejeqëndrim në vendet e BE-së.

Fjalë kyç: *liberalizim, azilkërkues, emigrim i parregullt, fluks dhe izolim.*

Cilësia a arsimit, studim krahasimor Kosovë - Finlandë

Prof. ass. dr. Lavdim Terziu

Kolegji AAB, Prishtinë
lavdim.terziu@aab-edu.net

Ass. Arlind Jerliu

Universiteti Kadri Zeka, Gjilan
arlind.jerliu@uni-gjilan.net

Abstrakt

Ky studim synon që të bëjë një krahasim ndërmjet sistemit të arsimit në Kosovë dhe atij në Finlandë. Metodologjia, mundësoi që të bëhet një krahasim ndërmjet këtyre dy vendeve, për të parë se cilët faktorë kryesorë ndikuan që arsimi finlandez të arrijë vendin e parë në testin ndërkombëtar PISA, dhe ku qëndron arsimi kosovar në raport me këta faktorë. Rezultatet e hulumtimit treguan se shumica e studiuesve pajtohen se Finlanda këtë mrekulli e kishte arritur duke krijuar mësimdhënës të shkëlqyer. Ndërkaq, gjetjet mbi cilësinë e arsimit në Kosovë, treguan se (i) përderisa Finlanda është bazuar vetëm në pranimin e studentëve me notat më të larta, në Kosovë mund të vërejmë se një numër i studentëve pranohen me nota më të ulëta; (ii) përgatitja e mësimdhënësve për tregun e punës lë për të dëshiruar; (iii) zhvillimi profesional i mësimdhënësve nuk u bazua në vlerësimin e performancës dhe me tendencën që të ketë efekt në vendin e punës; (iv) udhëzimi administrativ për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, pothuajse nuk ka gjetur fare zbatim, si pasojë e numrit të vogël të inspektorëve të arsimit dhe se nga ky udhëzim, i vetmi motiv mbetet rilicensimi i mësimdhënësve, gjë që nuk ka pasur ndonjë ndikim të mirë deri më tani. Nga kjo mund të përfundojmë se politikat e arsimit në Kosovë, nuk kanë qenë edhe aq të mira drejt ngritjes së cilësisë së arsimit.

Fjalë kyç: *Cilësia në arsim, Finlandë, Kosovë, përgatitje e mësimdhënësve, zhvillim profesional, vlerësim performance.*

Harmonizimi i legjislacioneve shtetërore me legjislacionin e BE-së

LL.M. Nazmi Elezaj

nazmielezaj@live.com

Abstrakt

Në këtë punim do të analizohet procesi i përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, si dhe sfidat nëpër të cilat kalojnë shtetet në këtë aspekt. Organi më i lartë ligjdhënës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjatë miratimit dhe plotësimit të ligjeve, duhet pasur parasysh që ato t'i parashikojnë standartet ndërkombëtare, të jenë në pajtueshmëri me ligjet ndërkombëtare, të mos merren parasysh propozimet diskriminuese të cilat sollën mjaft probleme funksionimin e mirëfilltë të shtetit tonë të ri. Nga harmozimi i legjislacioneve shtetëror me legjislacionin e BE-së kuptojmë se harmonizimi mund të jetë në të gjitha sferat, që nga e drejta tatimore, sociale sundimit të ligjit arsimit kulturës etj, në kuadër të krijimit të kushteve për funksionimin e mirëfilltë të sistemit juridiko-politik është edhe harmonizimi i vazhdueshëmi legjislacionit të Republikës Kosovës me atë të BE-së. Kosova është vendi më proevropian në rajon dhe ka konsensus të gjerë shoqëror për integrimet evropiane, gjë e cila e lehtëson procesin e miratimit të legjislacioneve për harmonizim me atë të BE-së. Kosova ka bërë progres në ndërtimin e institucioneve dhe është kompatible me kriteret e BE-së. Në procesin e miratimit të legjislacionit janë vendosur struktura formale që sigurojnë se legjislacioni i miratuar përputhet me atë të BE-së i njohur si "Acquis communautaire". Për më tepër, e drejta evropiane parasheh një seri ndryshimesh komplekse, të pavaruara në vendimarrje, por të ndërvuara në funksionimin efikas dhe të përgjithshëm. Në këtë aspekt Kosova po përballet me sfida serioze që ndërlidhen me harmozimin e legjislacionit shtetëror me legjislacionin e BE-së.

Fjalë kyç: *BE, Kosova, harmonizim, legjislacion etj.*

Dilemat e mësimdhënësve rreth zbatimit të planit mësimor në shkollat e Komunës së Kamenicës

Fatmir Agaj¹

Dr. sc. Fakulteti i Shkencave Sociale, AAB, Prishtinë

E-mail: fatmir.agaj@universitetiaab.com

Nazyktere Hasani²

Dr. sc. Fakulteti i Shkencave Sociale, AAB, Prishtinë

E-mail: nazyktere.hasani@universitetiaab.com

Abstrakt

Në pajtueshmëri me zhvillimin e hovshëm dhe të shpejtë tekniko-teknologjik dhe zhvillimit shkencor të shoqërisë, gjithnjë e më shumë po gjurmohen strategji, modele, forma, teknika dhe plane të reja mësimore të cilat do t'i kundërshtohen modelit arsimor tradicional. Qëllimi i këtij punimi është dalja në shesh e të vërtetës rreth zbatimit të planeve mësimore tradicionale dhe bashkëkohore nga mësimdhënësit e shkollave të Komunës së Kamenicës. Nga një monitorim dyvjeçar në shkollat e Komunës së Kamenicës, kemi kuptuar se edhe më tutje shkoqitja e planeve mësimore bëhet sipas mësimi tradicional. Problemi i gjithë kësaj çështjeje është se disa nga mësimdhënësit moshuar ende vazhdojnë punën sipas planit mësimor tradicional. Për të vërtetuar një gjë të tillë kemi përdor metodën e intervistimit me 170 mësimdhënës të SHFMU dhe SHML. Zgjedhja e kësaj problematike është hapja e mundësisë për punësim të mësimdhënësve të rinj në institucionet edukativo-arsimore që janë njohës dhe zbatues të mirë të Kurrikulës Bërthamë të Kosovës. Me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në arsim, një ndër mundësitë kryesore e kësaj qështjeje është: pensionimi i parakohshëm i mësimdhënësve të moshuar dhe të gjithë atyre që nuk e kanë mundësinë për shkaqe shëndetësore të zbatojnë planin mësimor sipas Kurrikules Bërthamë të Kosovës. Nga rezultatet e hulumtimit kemi ardhur në përfundim se mësimdhënësit e rinj janë njohës të mirë të zbatimit të planeve mësimore sipas Kurrikules Bërthamë të Kosovës, përderisa mësimdhënësit e moshuar pothuajse më tepër merren me zbatimin e planeve mësimore tradicionale.

Fjalë kyç: *plani mësimor, tradicional, kurrikulë, mësimdhënie, trajnim*

Roli i lidershipit në performancën e bizneseve kosovare

Prof. Ass. Dr. Fëllanzë Pula

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë
fellanze.pula@universitetiaab.com

Ass. Prof. Dr. Lulzim Shabani

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë
lulzim.shabani@universitetiaab.com

Abstrakt

Udhëheqja është një nga përcaktuesit kryesor që lidhen me suksesin dhe dështimin e ndonjë organizate. Stili i udhëheqjes është mënyra në të cilën njerëzit drejtohen dhe motivohen nga një lider për të arritur qëllimet organizative. Ky studim shqyrton ndikimin e stileve të lidershipit në performancën organizative të bizneseve kosovare. Studimi ka dhënë njohuri të thella për stilet e udhëheqjes dhe teori të ndryshme që kanë vënë theksin mbi ato karakteristikat e personalitetit të liderit dhe situata ku lideri ndodhet, që të dyja të rëndësishme në suksesin e liderit. Studimi është realizuar duke u bazuar në të dhënat primare të cilat janë marrë nga pyetësi i realizuar me menaxherët e bizneseve kosovare, ku mostër ishin 200 biznese. Gjetjet sugjerojnë se stili karizmatik, burokratik dhe lidershipi transaksional kanë marrëdhënie negative me performancën organizative. Stili i udhëheqjes transformuese, autokratike dhe demokratike, nga ana tjetër kishin një marrëdhënie pozitive me performancën organizative. Ky studim ka rëndësi mjaft të veçantë duke qenë se identifikon stilin e udhëheqjes i cili ka impakt më të madh në performancën e bizneseve, duke ndihmuar në dhënien e rekomandimeve orientuar bizneseve në funksion të përmirësimit të performancës organizative.

Fjalë kyç: *Lidership, performancë, stile udhëheqëse, biznese kosovare.*

Gjurmë të hebrenjëve në rajonin e Vushtrrisë. Minoritetet dhe gjendja e tyre në shtetet e Ballkanit

Mr.sc. Jeton Sallahu

e-mail: jetoni_juve@hotmail.com

Abstrakt

Ky punim ngërthen në vete pranimin e etnosit hebre në rajonin e Vushtrrisë nëpër kohë. E gjithë kjo shpjegon edhe pranimin e tyre në truallin shqiptar nga popullata shumicë, pra ajo shqiptare, kësisojshëm shpërfaq njëkohëshëm edhe një vlerë të shqiptarëve. Fjala është për pranimin e diversitetit, e që kjo e fundit korrespondon fort edhe me vetë thelbin e ekzistencës së Bashkimit Evropian. Ç'është e vërteta, rajoni i sipërpërmendur ka qenë i pasuruar edhe me të tjera kombësi, përfshirë këtu edhe hebrenjtë. Megjithatë, sot është vështirë të gjejmë në këtë rajon prani të etnosit hebre, porse në të kaluarën jo të largët, ata kishin qenë në këto anë, veçanarisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke u mirëpritur nga populli shqiptar, e ky i fundit edhe pse i rrezikuar nga forcat gjermane, i kishte ruajtur familjet hebreje në shtëpitë e tyre. Është interesant elaborimi i veprimtarisë edhe të një çifti doktorësh, që njeri prej tyre ishte i etnosit hebre-burri, gjersa për gruan nuk ka të dhëna të sakta për përkatësinë e saj etnike. Gjetjet dëshmojnë se sjellja e çiftit me popullsinë lokale shqiptare ka qenë mjaft e mirë dhe miqësore gjersa punonin në rajonin e Vushtrrisë, ndërsa gjithashtu popullsia i ka mirëpritur ata, gjë që dëshmon për vlera europiane të popullsisë lokale.

Fjalë kyç: *Gjurmë të hebrenjëve, Rajoni i Vushtrrisë, shqiptarë, diversiteti, Bashkimi Evropian.*

Sfidat e integritetit europian dhe Struktura të Pavarur Antikorrupsion në Kosovë (SPAK)

Nazmi Iballi

Kolegji AAB, Prishtinë
nazmi.iballi@kolegjiaab-edu.net

Abstrakt

Interesat nacionale dhe strategjike i ka cenuar dhe vazhdon t'i cenojë korrupsioni i pakontrolluar si faktor i brendshëm. Raporti i instituteve të pavarura mbi rangimin e vendeve të rajonit dhe Kosovës, tregon se korrupsioni megaloman është shtrirë thellë në të gjitha insitucionet. Një dukuri e tillë apo fenomen përveç që ka cenuar interesat strategjike të vendit për integritet e reforma, në të njëjtën kohë ka bërë që shoqëria kosovare në ndahet në klasë socio-ekonomike. Punimi synon të ndriçojë domosdoshmërinë e themelimit të një strukture sipas burimeve njerëzore, financiare, legjislative dhe infrastrukture antikorrupsion të institucionalizuar, e të quajtur SPAK. Vendet si Kosova duhet të kenë qëllime strategjike të angazhojnë ekspertë ndërkombëtarë përmes ndonjë kompanie të specializuar antikorrupsioni me strukturë të organizuar, të pavarur dhe me kompetenca ekzekutive cila ka ekspertizë në këtë fushë, për çka është edhe qëllimi i këtij punimi.

Fjalë kyç: *korupsion, kompani, Institute, interesa strategjike, specializuar, reforma, integritet*

Vlerësimi i shpejtësisë së konvergjencës reale të vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit European

Elkjer Qema, Dega e Thesarit, Has, Shqipëri

elkjer03qema@hotmail.com

Fatmira Qema, Bashkia Has, Shqipëri

Abstrakt

Një nga pritshmëritë kryesore për ekonominë në tranzicion është se procesi i ndërtimit të ekonomisë së tregut dhe integrimi european çon në një rritje të standarteve të jetesës, si dhe në arritjen e nivelit të të ardhurave për frymë të ekonomive të zhvilluara europiane. Në periudhën e fillimit të tranzicionit ekonomik, shumë vende ish-socialiste u anëtarësuan në BE dhe rritën në mënyrë të konsiderueshme PBB-në për frymë. Por jo të gjithë vendet në tranzicion kanë pasur të njëjtin fat. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ende shumë punë për të bërë në këtë aspekt. Përveç nevojës së dukshme për të përmbushur kriteret e anëtarësimit, një çështje e rëndësishme për këto vende është se sa mirë mund të "përshtaten" në BE, sa shpejt mund të përparojnë drejt gjendjes ekonomike të dëshiruar që do t'i bëjë ata lojtarë të barabartë në Europën e madhe. Kështu, në këtë punim do testohet për ekzistencën dhe shpejtësinë e konvergjencës reale të shteteve të BP drejt Bashkimit European. Pra, ashtu sikurse teoria ekonomike supozon, vendet me nivel më të ulët të të ardhurave për frymë tentojnë të kenë rritje më të madhe ekonomike se vendet e zhvilluara ekonomikisht.

Fjalë kyç: *konvergjencë reale, shpejtësi konvergjence, rritje ekonomike, integrim european*

Analizë e faktorëve të fenomenit *ikja e trurit* në ekonomitë e vendeve në zhvillim

Prof. Ass. Dr. Besime Ziberi

Fakulteti Ekonomik, Kolegji AAB, Kosovë
besime.ziberi@universitetiaab.com

Abstrakt

Ikja e trurit i referohet emigracionit të të diplomuarve universitarë nga vendi i origjinës. Është një fenomen shqetësues në përmasa globale. Ky studim ka për qëllim të studiojë faktorët shtytës dhe tërheqës për emigrimin e të diplomuarve universitarë të cilët njëherësh paraqesin ajkën intelektuale. Ky studim konsiston në metodën e kombinuar hulumtuese cilësore dhe sasiore përfshirë të dhënat parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore janë siguruar nëpërmjet instrumentit të pyetësorit i cili është shpërndarë online në mostër të qëllimshme prej 300 studentësh të diplomuar dhe në proces të diplomimit. Të dhënat dytësore janë siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe përfshijnë variablat mbi normën e punësimeve dhe papunësisë të të diplomuarve universitarë ndër vite dhe sektorët deficitarë në tregun e punës. Këto variabla përfshihen në analizë si rezultat i mungesës së të dhënave mbi normën e emigrimit të të diplomuarve universitarë. Ky studim në vete paraqet analizën e korrelacionit, regresionit linear, testin Chi square, Cronbach's alpha dhe tabelat e kryqëzuara të cilat janë testuar me program SPSS. Studimi vjen në konkluzion se një nga faktorët kryesorë shtytës për të emigruar të diplomuarit universitarë është nepotizmi dhe pamundësia për avancim në karrierë, kurse faktori kryesor tërheqës është meritokracia dhe standardi i lartë jetësor. Studimi rekomandon që të hapen vende të reja pune dhe të zbutet diskrepanca në mes të profileve të të diplomuarve universitarë dhe kërkesave reale për shkathtësi në tregun e punës në vendet në zhvillim me theks të veçantë në Kosovë.

Fjalë kyç: *të diplomuar universitarë, ikje e trurit, faktorë shtytës, faktorë tërheqës, nepotizëm, meritokraci.*

Ndikimi i cilësisë së shërbimeve në lojalitetin e klientëve të bankave komerciale në Kosovë

Dr. Sc. Arbëresha Behluli

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë
arberesha.behluli@universitetiaab.com

Dr. Sc. Fidan Qerimi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë
fidan.qerimi@universitetiaab.com

PhD C Rifat Haxhija

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë
rifat.haxhija@universitetiaab.com

Abstrakt

Cilësia e shërbimit konsiderohet fenomen subjektiv që varet nga perceptimet personale të klientëve, mjet i rëndësishëm për matjen e kënaqësisë dhe lojalitetit të klientit. Duke pasur parasysh përfitimet që një organizatë mund të ketë si rezultat i përmirësimit të niveleve të lojalitetit, ka bërë që kompanitë të iniciojnë masa të ndryshme për të rritur besnikërinë e klientëve të tyre. Referuar kësaj, përmes këtij hulumtimi do të matet ndikimi i cilësisë së shërbimit përmes metodës SERVQUAL bazuar në pesë dimensionet e saj (materiale të prekshme, besueshmëri, përgjegjshmëri, siguri dhe ndjeshmëri) në lojalitetin e klientëve të bankave komerciale në Kosovë të ndara sipas kapitalit. Popullatë e këtij hulumtimi janë klientët e bankave komerciale të Kosovës të ndara sipas kapitalit, ku mostër janë nga 200 klientë nga secila kategori e bankave. Pas mbledhjes së të dhënave bazuar në metodën kuantitative, analiza e të dhënave është bërë përmes Paketës Statistikore për Shkenca Sociale. Sipas rezultateve të hulumtimit, bazuar në regresionin ordinal dhe analizën e korrelacionit, vijmë në përfundim që cilësia e shërbimit ndikon në lojalitetin e klientëve, ku dimensionet më ndikuese në lojalitetin e klientëve rezultuan të jenë besueshmëria dhe përgjegjshmëria. Duke u bazuar në këto rezultate, ky hulumtim ka rëndësi mjaft të madhe sepse jo vetëm që mat ndikimin e cilësisë së shërbimit në lojalitetin e klientëve, por edhe identifikon dimensionin më ndikues të metodës SERVQUAL në lojalitetin e klientëve duke mundësuar në këtë formë në fuqizimin e dimensioneve me rezultat më të ulët, ku fokusi i gjithë kësaj është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe rritja e lojalitetit të klientëve.

Fjalë kyç: *Cilësia e shërbimeve, lojalitet i klientëve, banka komerciale.*

Sfidat e grave sipërmarrëse në vendet në tranzicion, rast studimi-Kosova

Prof.Ass.Dr. Rrezarta Gashi

Fakulteti Ekonomik, Kolegji AAB, Kosovë
rrezarta1.gashi@universitetiaab.com

Abstrakt

Sfidat e gruas sipërmarrëse në vendet në zhvillim ndikojnë dukshëm produktivitetin e punës pasuar me kreativitetin dhe inovacionin. Ky studim ka për qëllim të analizojë sfidat e gruas sipërmarrëse në rastin e Kosovës duke përfshirë në analizë qasjen në financa kryesisht mënyrën e financimit të biznesit, ndikimin e aspekteve socio-kulturore dhe vështirësitë në depërtimin në treg. Ky studim në vete përfshin literaturë të gjërë teorike dhe empirike. Të dhënat në këtë studim janë primare të cilat janë siguruar nga instrumenti i pyetësorit me mostër të qëllimshme, konkretisht, gratë sipërmarrëse në rajonin e Kosovës si një vend në zhvillim e sipër. Në studim janë shfrytëzuar edhe të dhëna dytësore të siguruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës që pasqyrojnë numrin e grave sipërmarrëse në rastin e Kosovës dhe profesionet ndër vite. Në analizë të të dhënave ky studim përfshin analizat përshkruese statistikore, frekuencat, korrelacionin Pearson dhe Regresionin linear OLS. Të dhënat janë testuar nëpërmjet programit SPSS. Studimi vjen në konkluzion se sfida kryesore për gratë sipërmarrëse në Kosovë është qasja në financa kryesisht financimi i biznesit, kredimarrja dhe aspektet socio-kulturore që për sektorë të caktuar si automatizimi dhe sektori i teknologjisë së informimit akoma e shohin gruan si burim jo të përshtatshëm për sipërmarrje. Studimi vjen me rekomandime për politikëbërjen që me politika adekuate fiskale dhe monetare, të promovojë gruan sipërmarrëse në Kosovë.

Fjalë kyç: *gratë sipërmarrëse, inovacion, treg i punës, kreditim.*

Roli i organizatave financiare ndërkombëtare në investimet infrastrukturore në vendet e Ballkanit Perëndimor

PhD (S), Uran Radoniqi

Universiteti i Evropës Juglindore, Republika e Maqedonisë së Veriut
ur29092@seeu.edu.mk

Msc., Zana Radoniqi

Ministria e Financave, Republika e Kosovës
zana.p.radoniqi@rks-gov.net

Prof.Dr.Drita Konxheli

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Republika e Kosovës
drita.konxheli@uni-pr.edu

Abstrakt

Ky studim ka për qëllim të analizojë rolin e Organizatave financiare ndërkombëtare (Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botëore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim etj) në zhvillimet infrastrukturore në 6 Vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia), jo vetëm në aspektin e përmirësimit të kushteve për vendin ku ka ndodhur investimi, por edhe në aspektin e rritjes së bashkëpunimit e lidhjes së vendeve mes vete dhe lehtësimit të kushteve drejt integritimeve Evropiane. Infrastruktura paraqet një sektor kyç zhvillimor në Bashkimin Evropian, ndër të tjera edhe sepse mundëson plotësimin e vizionit dhe ruajtjes së vlerave mbi të cilat është ndërtuar. Duke qenë se infrastruktura paraqet një element shumë të rëndësishëm për Bashkimin Evropian, kjo e fundit ka krijuar plane, strategji dhe iniciativa të shumta për integrimin e 6 Vendeve të Ballkanit Perëndimor nga fusha e infrastrukturës të cilat janë përkrahur në masë të madhe edhe nga organizatat financiare ndërkombëtare. Punimi përfundon se investimet infrastrukturore në 6 Vendet e Ballkanit Perëndimor përkundër faktit që janë përcjellë me shumë polemika dhe paqartësi, paraqesin investime të domosdoshme dhe me shumë perspektivë për integrimin e rajonit dhe se roli i organizatave financiare ndërkombëtare në këtë proces është i pazëvendësueshëm.

Fjalë kyç: zhvillimi ekonomik, transporti, energjia, integritet evropiane, bashkëpunimi fqinjësor.

Drejt një gjyqësori të pavarur dhe jokorruptiv në përputhshmeri me praktikat e Bashkimit Evropian

Dr. sc. Mensut Ademiti

Kolegji " AAB "

Fakulteti Juridik

mensut.ademi@aab-edu.com

mensut.ademi@gmail.com

Prof.Dr.Ismajl Zejneli

South East European University

Fakulteti Juridik

i.zejneli@seeu.edu.mk

Abstrakt

Pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe ai gjyqësor që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vazhdimësi është duke bërë përpjekje që të miratojë dhe të plotësojë legjislacionin me ligje në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Deri me tani ligjet e miratuara kanë mundur të jenë në përputhshmëri me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Në Republikën e Kosovës është tentuar shumë herë të ketë një infrastrukturë ligjore të mirë, por edhe më tutje mbetet sfiduese për organet e zbatimit të ligjit që përmes aktorevë dhe kriterëve të arrijë në implementimin e disa ligjeve e sidomos atyre si masë preventive dhe represive për ta luftuar korrupsionin në të tri pushtetet e Republikës Kosovës. Një nga mekanizmat për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar për ofrimin e sigurisë për të të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, janë ndërmarrë disa herë propozime, për të arritur deri te ligji për konfiskimin e pasurisë të përfituar nga vepra penale. Përmes këtij ligji do të kontrollohej më lehtë prejardhja e pasurisë së personave të dyshuar qoftë në legjislativ, ekzekutiv e veçanërisht në gjyqësor. Në Kosovë ekziston Agjencia Kundër Korrupsionit e cila ka për detyrë dhe përgjegjësi të luftojë dhe parandalojë korrupsionin, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit. Kosova ka pasur probleme shumë të mëdha me sistemin juridik tejet të komplikuar. Ky sistem ishte i përbërë nga nivele të ndryshme të "ligjit të zbatueshëm", që kishte krijuar pasiguri juridike.

Fjalë kyç: *legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, korrupsion, parandalim, luftim*

Ballkani Perëndimor: geto apo pjesë e kontinentit – perspektivat e anëtarësimit

Prof. Ass. Dr. Vjosa Jonuzi – Shala

Kolegji AAB, Fakulteti Juridik, Prishtinë
vjosa.jonuzi-shala@universitetiaab.com

Abstrakt

Njëjtësimi me Europën, përtej kushteve tashmë të njohura, si: sundimi i ligjit, siguria, zhvillimi ekonomik, heqja e shpenzimeve të *roaming*-ut, rregullimi i infrastrukturës rrugore, ndalja e migrimit, agjenda digjitale, pajtimi dhe marrëdhëniet fqinjësore, kërkon edhe disa kushte të tjera, ndër të cilat është edhe vetëdijësimi për mbrojtjen e mjedisit, që në të vërtetë paraqet aspektin thelbësor, paraqet përmbajtjen e perspektivës europiane. Në këtë prezantim do të trajtohen aspektet që kanë të bëjnë me gjendjen mjedisore në disa këndvështrime. Përveç këndvështrimit legjislativ - krahasues me shtetet e zhvilluara perëndimore, do të prezantohet edhe aspekti statistikor, me ç'rast do të paraqitet puna e gjykatave (numri i personave të dënuar, lloji dhe masa e dënimeve, të cilat janë shqiptuar) prej vitit 2003 deri në vitin 2020 sa i përket veprave penale kundër mjedisit. Objekt i prezantimit do të jetë edhe mënyra e trajtimit të objekteve të trashëgimisë nga e kaluara si dhe shprehitë e caktuara, të cilat janë prezente në Ballkanin Perëndimor në lidhje me trajtimin e natyrës dhe prishjen e baraspeshës së saj, duke shkaktuar rrënimin e ekosistemit. Disa shprehi në këtë pjesë të Europës, që mund të jenë shkak i getoizimit të saj, kanë të bëjnë edhe me trajtimin e botës bimore dhe shtazore, që dëshmon mendësinë e saj, e që shkon përtej rrënit të ekosistemit.

Fjalë kyç: *Mjedis, dënime, ekosistem, trashëgimi, kulturë.*

Ballkani Perëndimor: një geto apo pjesë e Unionit Evropian – Rasti i Kosovës?

Arjeta Kurtaj

Militant Plakolli

Kolegji AAB, Prishtinë

E-mail: arjeta.kurtaj@universitetiaab.com

militant.plakolli@universitetiaab.com

Abstrakt

Integrimi në Unionin Evropian kërkon shumë punë në kuadrin e forcimit të shtetit ligjor dhe demokratik, gjë që shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk janë akoma të fuqishme politikisht për të bërë hapa të mëdhenj në këtë drejtim. Qëllimi i këtij hulumtimi përvijohet në gjetjen e shkaqeve dhe pasojave të ngecjes së integrimit të Ballkanit Perëndimor në Unionin Evropian, veçanërisht Kosova. Kjo bën që ky punim të jetë kryesisht i fokusuar në metodologjinë kualitative dhe analitike, përfshirë edhe metodologjinë krahasuese, e cila në këtë aspekt ndihmon në gjetjen e dallimit të qasjes së Unionit Evropian në procesin integruar të Kosovës, kundrejt raportit dhe qasjes integruar në lidhje me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Rezultatet dëshmojnë se me gjithë sfidat potenciale, qeveritë e vendeve të këtij rajoni kanë bërë relativisht mirë punën e tyre në procesin integruar evropian, por që në të shumtën e rasteve këto shtete kanë mbetur pengje të diskurseve politike të së kaluarës, gjë që pengon seriozisht procesin e tyre integruar. Rajoni mbetet akoma i hapur ndaj ideologjive denigruese për demokracinë dhe vetë kulturën politike liberale që ky union e ka zhvilluar për më shumë se një gjysmëshekulli. Por, punimi konstaton se integrimi i plotë i Ballkanit Perëndimor në Unionin Evropian, fillimisht, është domosdoshmëri e këtij rajoni për sigurinë, politikën dhe demokracinë europiane.

Fjalë kyç: *Unioni Evropian, Ballkani Perëndimor, Kosova, integrim evropian*

Sfidat e anëtarësimit të Kosovës në Unionin European

Diellon Kelmendi, Kolegji AAB

Email: diellon.kelmendi@universitetiaab.com

Abstrakt

Shtetet dhe individët nuk janë të vetmit aktorë në politikën ndërkombëtare. Rol në sistemin ndërkombëtar luajnë dhe organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare. Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë njohuri themelore të parimeve fundamentale të organizatave ndërkombëtare duke pasur për synim zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve për interpretim analizen e trendeve dhe zhvillimeve shumë dinamike ndërkombëtare. Pyetja që shtrohet këtu është nëse ka arritur Kosova të përmbushë rolin e vetë në menaxhimin e suksesshëm në përmbushjen e misionit të përcaktuara që të antarësohej në organizata ndërkombëtare, përfshirë OKB-në? Do të analizojmë rolin e organizatave ndërkombëtare për të promovuar paqe dhe siguri ndërkombëtare, për të krijuar marrëdhënie miqësore mes shteteve të pavarura dhe sovraane dhe për ta arritur një bashkëpunim ndërkombëtar. Për realizimin e punimit kemi zgjedhur të analizojmë sistemin ndërkombëtar, të hedhim një vështrim historik për kontekstin e krijimit të sistemit ndërkombëtar dhe të përshkruajmë strukturat organizative si dhe misionin e tyre si dhe do të krahasojmë veprimet e Kosovës për të përmbushur kriteret e organizatave ndërkombëtare, e veçanërisht anëtarësimi në Unionin European.

Fjalë kyç: *Kosova, Unioni European, antarësim, sfida, rezultat.*

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë 2021, procesi, sfidat, rezultati

Prof. Ass. Dr. Ramë Buja, Dr. sc. Vrullim Buja

Kolegji AAB, Prishtinë
ramë.buja@universitetiaab.com
vrullim.buja@universitetiaab.com

Abstrakt

Zgjedhjet parlamentare këtë vit në Kosovë për shumë arsye ishin të pazakonshme, në radhë të parë që ishin të parakohshme, se ndodhen në kohë pandemie dhe se sollën një rezultat të habitshëm. Procesi zgjedhor u zhvillua më mirë dhe më qetë se asnjëherë tjetër dhe atë pa prezencën e mbikëqyrësve dhe monitoruesve ndërkombëtar, që ishin prezent në të gjitha zgjedhjet e mëparme. Kjo tregoi se ne dijmë dhe mundemi atëherë kur duam. Komunikimi i subjekteve politike gjatë tërë fushatës ishte relativisht korrekt. Dita e zgjedhjeve dëshmoi për një kulturë të veçantë politike, që nuk ka të krahasuar me asnjë vend të rajonit dhe më gjerë. Sistemi shumëpartiak është sfida e parë për vështirësitë që krijon në organizim të mirëfilltë të zgjedhjeve në një ambient të tillë. Pjesëmarrja e 28 subjekteve politike nga popullsia shumicë dhe komunitetet pakicë, krijoi vështirësinë e radhës, por sfida kryesore dhe me rrezikshmëri të lartë, kësaj radhe, ishte pandemia Covid 19! Kishte edhe sfida të tjera që do t'i sqarojmë e rendisim në verzionin e zgjeruar të punimit. Sistemi politik plural, ai kushtetues dhe ligjor i Republikës së Kosovës, të imponon, në njëfarë mënyre edhe limitet e rezultateve zgjedhore të subjekteve politike. Por, kësaj radhe, pothuajse u thyen këto rregulla, jo duke i shkelur, por duke i tejkaluar me rezultatin zgjedhor që rezultoi! Një subjekt politik, me rezultatin preliminar, po i ofrohet pesëdhjetë përqindëshit të votës së fituar, me mundësi tejkalmi në rezultatin përfundimtar!

Fjalë kyç: *zgjedhje, pluralizëm, sfidë, pandemi, organizim, tubim.*

Dialogu Kosovë-Serbi në kontekst të integrimeve europiane

Prof.Ass.Dr. Donik Sallova

donik.sallova@aab-edu.net
Fakulteti i Administratës Publike
Kolegji AAB

Abstrakt

Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk kishte cënuar të drejtën ndërkombëtare, solli në vitin 2010 Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e cila e njihte këtë mendim këshillues-rekomandues të GjND-së, por njëkohësisht e ngarkonte Bashkimin Evropian të lehtësonte normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes një dialogu i cili do të zhvillohej në kontekst të rrugëtimit të të dyja vendeve drejt anëtarësimit në BE. Ky dialog i cili në vitet e para u zhvillua si dialog për çështje teknike, nga viti 2013 kaloi në dialog politik që rezultoi me marrëveshje që sollën në diskutim natyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemit politik në Kosovë. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë dhe interpretojë ndikimin që ky dialog ka pasur në arritjen e qëllimësisë për të cilën ishte inicuar, pra normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi edhe si kriter matës i progresit të të dyja shteteve në procesin e integritimit evropian. Punimi do të trajtojë edhe pasojat politike të brendshme dhe të jashtme të devijimit të dialogut në Bruksel nga dialog i nivelit teknik në dialog politik i cili Kosovën e vendosi në kontekstin e statusit të pazgjidhur përfundimisht dhe këtë zgjidhje e lidhe me domosdoshmërinë e njohjes nga Serbia.

Fjalë kyç: *dialog, normalizim, integrim, Kosovë, Serbi, BE.*

Narativa e lajmeve të Deutsche Welle-së (DW) mbi integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor gjatë presidencës gjermane të BE-së

Festim Rizanaj

PhD Candidate, Journalism
Anadolu University, Turkey
festimrizanaj@anadolu.edu.tr

Abstrakt

Gjermania në periudhën 1 korrik 2020 – 31 dhjetor 2020 ka udhëhequr me Bashkimin Evropian. Gjermania startoi Presidencën 6-mujore të Këshillit European në një moment kyç për BE-në. Ashtu si edhe në presidencën e vitit 2007, Gjermania me Kancelaren Merkel duhej të përballej me sfidat e rëndësishme, ku objektiv prioritar ishte rimëkëmbja ekonomike e Europës, rikthimin e besimit të qytetarëve evropianë në institucionet e BE-së dhe pa diskutim një reagim solidar në adresimin e krizës së pandemisë. Kalimi i Presidencës së Këshillit të Bashkimit European në Berlin për shtetet e Ballkanit Perëndimor që vazhdimësi e vëmendjes që i ishte kushtuar rajonit që nga janari i 2018-ës. Si iniciatore e Procesit të Berlinit, presidenca gjermane ka luajtur një rol sa simbolik edhe konkret, duke treguar vitet e fundit vëmendje të shtuar për rajonin. Për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, presidenca gjermane përbënte një shpresë në kërkim të vendimit për hapjen e negociatave të pranimit. Si transmetues ndërkombëtar i Gjermanisë Deutsche Welle (DW), i ka kushtuar hapësirë të konsiderueshme lajmeve në lidhje me politikën dhe zhvillimet brenda BE-së gjatë presidencës gjermane të BE-së. Ky punim, synon të paraqesë narrativën e lajmeve të Deutsche Welle-së (DW) në gjuhët ballkanike në lidhje me politikën e presidencës gjermane të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor. Lajmet e publikuar gjatë periudhës 01 Korrik 2020 deri më 31 Dhjetor 2020 i janë nënshtruar analizës përmbajtësore për të nxjerrë në pah narrativën brenda lajmeve.

Fjalë kyç: *Presidenca gjermane e BE-së, Ballkani Perëndimor, Deutsche Welle (DW), narativa e lajmeve*

Efektet e MSA-së në bilancin tregtar të Kosovës

PhD Can, Asdren Toska

Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë

email: at16851@seeu.edu.mk

Abstrakt

Sfidë e shumë shteteve mbetet përmirësimi i bilancit tregtar, duke tentuar që sa më shumë t'i rrisin eksportet dhe të jenë prezente në shtetet e jashme. Për këtë rëndësi të bilancit tregtar, theksohet fakti i shumë marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale që fokusohen në lehtësimin e tregtisë ndërmjet shteteve anëtare si ajo e GATT-it dhe pastaj OBT-së. Kosova si shtet i ri nuk hezitoi të jetë pjesë e disa marrëveshjeve ndërkombëtare që lehtësojnë tregtinë. Një ndër marrëveshjet më të rëndësishme të Kosovës konsiderohet marrëveshja e MSA-së. Hulumtimi thekson rëndësinë e kësaj marrëveshjeje dhe kontributin e saj në lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të Kosovës. Hulumtimi merr për bazë një periudhë katërvjeçare para MSA-së, duke krahasuar me periudhën tjetër katërvjeçare pas MSA-së. Të dhënat tregojnë që MSA pati efekt pozitiv në rrijen e eksporteve të Kosovës në tregun evropian, me mesatarisht 10.87% në 4 vjetët pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Po ashtu, edhe importet nga BE-ja u rritën mesatarisht për 12.05% pas hyrjes së marrëveshjes në fuqi. Gjetje tjetër është se MSA-ja pati efekt edhe në rritjen e eksporteve të përgjithshme të Kosovës mesatarisht për 4.71% në katër vjetët pas marrëveshjes. Ndërsa gjetje tjetër është që edhe pas marrëveshjes së MSA-së, Kosova sërish shoqërohet me deficit tregtar, ku mund të konkludojmë që MSA-ja nuk pati efekt në zvogëlimin e deficitit tregtar të Kosovës.

Fjalë kyç: *MSA, eksport, import, bilanc tregtar*

Aplikimi i metodës së modifikuar ne zgjidhjet optimale të shpërndarjes ne reduktimet e shpenzimeve te transportit tek bizneset.

Shaip Bytyçi - Kolegji AAB Prishtine Kosove, email: shaip.bytyqi@aab-edu.net

Ervin Myftaraj- Univeristeti UAMD – Durres Shqiperi

Rifat Haxhija- Kolegji AAB Prishtine Kosove

Abstrakt

Metoda e modifikuar e shpërndarjes, njihet gjithashtu si metoda MODI ose metoda (u - v) ofron një zgjidhje me kosto minimale për problemet e transportit. Metoda studion minimizimin e koston së transportimit të një malli nga një numër burimesh në disa destinacione. Furnizimi në secilin burim dhe kërkesa në secilin destinacion. Objektivat janë të zhvillojnë dhe rishikojnë një orar integral të transportit që plotëson të gjitha kërkesat nga inventari me një kosto minimale totale, shpenzimet e transportit, përfshirë edhe taksat e ndryshme rrugore me një zgjidhje me kosto minimale (zgjidhje optimale) për problemin e transportit. Metoda MODI (shpërndarja e modifikuar) na lejon të llogarisim indeksat e përmirësimit shpejt për secilin katror të papërdorur pa vizatuar të gjitha shtigjet e mbyllura. Për shkak të kësaj, shpesh mund të sigurojë kursime të konsiderueshme të kohës mbi metodat e tjera për zgjidhjen e problemeve të transportit. Kjo metode siguron një mjet të ri për të gjetur rrugën e papërdorur me indeksin më të madh negativ të përmirësimit. Pasi të identifikohet indeksi më i madh, na kërkohet të gjurmojmë vetëm një rrugë të mbyllur. Kjo rrugë ndihmon në përcaktimin e numrit maksimal të njërive që mund të transportohen përmes rrugës më të mirë të papërdorur.

Fjalë kyç: *Metoda Modi, shpërndarje, transport, shpenzime.*

Përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian

Safet Beqiri, PhD.

Komisioni për Integrim Evropian, Kuvendi i Kosovës

E-mail: safet.beqiri@gmail.com

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të paraqesë përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së, si një interes i dyfishtë si nga ana e studimit dhe të shpjegimit të këtij procesi, po ashtu edhe nga praktikuesit apo zbatuesit e tij. Në këtë artikull së pari do të shpjegohet legjislacioni i BE-së, përkatësisht legjislacioni primar dhe sekondar, pastaj kuptimi i dy definicioneve të përdorura siç është përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit, më pas procesi i përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit shtetëror dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky proces. Proces i përafrimit dhe harmonizimit të legjislacion është një instrument i rëndësishëm i integritetit evropian, i cili kalon nëpër disa faza të rëndësishme për shtetin aspirues për anëtarësim në BE. Megjithatë, ky proces nuk i dedikohet vetëm shtetit i cili ndodhet në procesin e anëtarësimit, por para se gjithash një proces i tillë i referohet së pari vetë shteteve anëtare të BE-së, pastaj shteteve që janë në procesin e anëtarësimit, si dhe shteteve të treta të cilat mbajnë marrëdhënie të veçanta me BE-në ose shtetet anëtare të saj. Ky punim analizon dhe përpiqet të shpjegojë procesin e përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), si dhe mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në BE.

Fjalë kyç: *përafrim, harmonizim, legjislacion i BE-së, anëtarësim, MSA, Kosova.*

Sfidat e integritetit të Republikës së Maqedonisë Veriore në BE

Dr. sc. Agim Beqiri & PhD Ismail Kamberi

Kolegji AAB

E-mail: agim.beqiri@universitetiaab.com

ismail.kamberi@unite.edu.mk

Abstrakt

Ky punim merret me rrugën e Maqedonisë së Veriut drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sfidat dhe vështësitë e këtij rrugëtimi. Gjithashtu punimi merret me procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian, disponimin e Unionit për zgjerim dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë vendet aspirante. Në punim jepet edhe një retrospektivë qëndrimit të samiteve, duke filluar nga ai i Parisit, Kopenhagës, Nicës dhe i Selanikut. Punimi përqendrohet në traktatin e Kopenhagës në të cilin kërkohet që shtetet që aderojnë në BE t'i respektojnë të drejtat e njeriut, demokracinë dhe lirinë e shprehjes, më një fjalë funksionimi i shtetit ligjor. Gjithashtu punimi flet për procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian drejt Ballkanit Perëndimor dhe Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim dhe partneritetin me BE-në. Sa i përket Maqedonisë së Veriut, punimi trajton Marrëveshjen e Prespës si parakusht që Greqia ia kërkoi Maqedonisë së Veriut për ndryshimin e emrit kushtetues. Një çështje tjetër që trajtohet është është problemi aktual që ka Republika e Maqedonisë së Veriut me Republikën e Bullgarisë për historinë e përbashkët, gjuhën dhe identitetin.

Fjalë kyç: *Maqedonia e Veriut, MSA, Greqia, Bullgaria, BE, anëtarësim.*

Ndryshimi i rendit botëror dhe ndikimi i tij në bisedimet Kosovë-Serbi

Mentor Lecaj, PhD

Kolegji AAB

E-mail: mentor.lecaj@universitetiaab.com

Abstrakt

Ndryshimi i rendit botëror nga sistemi unipolar (ku SHBA-të dominonin tërësishtë globin si një hegjemoni) drejt sistemit multipolar (me ngritjen e vazhdueshme të Kinës në aspektin ekonomik dhe ushtarak, kthimin e Federatës Ruse në sistem si një aktor i rëndësishëm) shtyn shtetet europerëndimore e posaçërisht SHBA-të, që t'i bëjnë presion vendeve të Ballkanit Perëndimor e sidomos Kosovës dhe Sërbisë, për të arritur marrëveshjen përfundimtare të paqes. Kjo marrëveshje do t'i shpie këto vende në institucionet euroatlantike. Kjo pjesë e integruar e Evropës në të ardhmen do të mbetet jashtë ndikimit rus dhe atij kinez, kështu që SHBA-të dhe Evropa e konsoliduar përfundimisht do të hyjnë në një fazë të re konkurruese në domenin ekonomik, politik dhe ushtarak me vendet e kontinentit aziatik e posaçërishtë Kinën. Ky artikull ka për qëllim që t'i bëjë një analizë situatës dhe zhvillimeve aktuale globale, të cilat ndikojnë në "zgjidhjen finale" të mosmarrëveshjeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor e veçanërisht në dialogun Kosovë -Serbi.

Fjalë kyç: *Sistem unipolar, sistem multipolar, Ballkani Perëndimor, integrimi euroatlantike.*

Prezenca e korrupsionit zyrtar si pengesë e integritetit të Republikës së Kosovës në Bashkimin European

Albrim Kastrati, PhD Candidate

Dr.Sc. Emrush Kastrati, Kolegji AAB

Abstrakt

Sikundër çdo vepër tjetër penale që është me rrezikshmëri shoqërore, po ashtu edhe veprat penale të korrupsionit zyrtar, i kanë tiparet e rrezikshmërisë shoqërore. Veprat penale të korrupsionit zyrtar janë me rrezikshmëri shoqërore, për faktin se kemi të bëjmë me veprime të kundërligjshme të kryesve të kësaj veprë penale, e që kryesit e saj janë pjesë e organeve shtetërore, duke përfshirë përveç organeve administrative, edhe organet gjyqësore, kurse këto vepra penale bëjnë pjesë në grupin e veprave penale të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare. Në gjykatat e Republikës së Kosovës, aktualisht janë në vazhdim e sipër një numër i konsiderueshëm i rasteve duke u gjykuar zyrtarë të ndryshëm për këto vepra penale, ndërsa për motivacion kanë korrupsionin. Element qenësor i këtij krimi është cenimi apo shkelja e detyrës zyrtare nga ana e personave zyrtarë përmes shfrytëzimit dhe veprimeve të kundërligjshme të pozitës apo autorizimeve zyrtare lidhur me detyrën e tyre zyrtare. Të gjitha organet ekzekutive si dhe ato gjyqësore, janë duke u angazhuar që në kuadër të autorizimeve të tyre zyrtare, të parandalojnë dhe të gjykojnë korrupsionin si një e keqe më e madhe e një shoqërie. Por, lind pyetja se sa organet e cekura kanë pasur sukses në parandalimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale, e që janë edhe detyrat kryesore e këtyre organeve.

Fjalë kyç: *keqpërdorim, shfrytëzim, korrupsion, parandalim, gjykim.*

Korrupsioni si pengesë e integritetit evropian të Kosovës

Mërgim Bekteshi

Kolegji AAB, Prishtinë

Programi Juridik, LL.M Civilo Juridik

mergim2.bekteshi@universitetiaab.com

Abstrakt

Përkundër vullnetit të kosovarëve për të siguruar një lëvizje të lirë drejt Bashkimit Evropian, kjo e fundit nga Raporti i Progresit (Bruksel, 6.10.2020) ende vazhdon të numërojë parregullsi, me një gjyqësor të korruptuar, mungesë dhe jogatishmëri e prokurorisë për të ndjekur kryesit e veprave penale sidomos ato nga fusha ekonomike. Dobësitë e evidentuara në këto fusha, sipas Raportit, paraqesin jostabilitet qeveritar, krahas ndërrimit të shpeshtë të qeverive, pa arritur të përfundojnë mandatin e tyre katërvjeçar sipas kushtetutës. Kjo bën që të mbeten pezull projektet në luftën kundër korrupsionit. Po ashtu, një faktor komplementar është edhe struktura e drejtueseve të institucioneve, e cila për një kohë shumë të gjatë qëndron në pozitat kyçe duke bërë të mundur kontrollin enorm në të gjitha fushat e zhvillimit ekonomik. Pa faj në këtë proces nuk është as bashkësia ndërkombëtare (UNMIK) e cila administroi me një apati dhe fill pas kësaj Bashkimi Evropian (EULEX), duke u fokusuar më shumë në monitorim të institucioneve dhe duke u bërë pjesë e një fushate të dobët për të luftuar korrupsionin. Shoqëria kosovare është në një ngërç të madh në mes të kriterëve të Bashkimit Evropian të cilat janë selektive për mundësimin e liberalizimit të vizave, dhe qeverive të saj për të krijuar një stabilitet në fushën ekonomike, politike dhe të drejtësisë në vend.

Fjalë kyç: *korruption, Bashkimi Evropian, jostabilitet qeveritar.*

Efekti i pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës

Prof.ass.dr. Agim BERISHA

email: agim.berisha74@hotmail.com

Abstrakt

Pjesë e trajtimit në kuadër të punimit është Bruto Produkti Vendor përfshirë ecurinë e proceseve ekonomike në kohën e pandemisë Covid-19 në Kosovë. Tregues i rëndësishëm në ekonominë e një vendi është Bruto Produkti Vendor-BPV (Gross Domestic Product-GDP). Pandemia Covid-19 e filluar në fund të vitit 2019 duke u përhapur në fillim të vitit 2020 në të gjitha vendet e botës, kështu që edhe Kosova u përfshi nga kjo pandemi duke filluar nga muaji mars 2020. Në Kosovë me vendim të Qeverisë, masat e para emergjente për parandalimin e përhapjes së pandemisë janë marrë në muajin mars 2020. Nisur nga kjo, pandemia përveç tjerash ka ndikuar edhe në proceset ekonomike në vende të ndryshme të botës, si dhe duke pasur ndikim dhe efekte edhe në proceset ekonomike në Kosovë. Qëllimi i këtij studimi konsiston në analizën e ecurisë së Bruto Produktit Vendor në Kosovë viteve të fundit dhe në kohë të pandemisë Covid-19. Në kuadër të këtij studimi për arritjen e objektivave përdoren kryesisht metoda e analizës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, duke analizuar në dinamikë çështjen që lidhen me Bruto Produktin Vendor dhe tregues tjerë makroekonomikë. Rezultatet dhe rekomandimet e këtij studimi janë të dobishme edhe për politikëbërësit në Republikën e Kosovës.

Fjalë kyç: *Pandemia Covid-19, Bruto Produkti Vendor, rritje ekonomike, shkalla e papunësisë, aktivitete ekonomike.*

Mbështetja financiare e BE-së për Shqipërinë përgjatë procesit të anëtarësimit

Erjon Nexhipi

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Dr. Adelina Nexhipi,

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

E-mail: adelinanexhipi@yahoo.com

Abstrakt

Politika e zgjerimit e BE-së është përshtatur për të siguruar integrimin e qetë të shteteve të reja anëtare dhe për të adresuar më mirë nevojat e vendeve në transformim. Për të ndihmuar vendet kandidate për të përmbushur kushtet e përcaktuara për anëtarësim, BE-ja (në Këshillin Evropian të Esenit, dhjetor 1994) hartoi një strategji "para-pranimi". BE-ja ofron ndihmë dhe nxit investimet në vendet kandidate për të mundësuar përgatitjen e tyre, për t'iu përshtatur më shpejt kërkesave të BE-së dhe për t'u anëtarësuar pa vonesa të panevojshme e pa periudha të gjata kalimtare.

Qëllimi i këtij studimi përshkruar - analitik është të analizojë qëllimet, prioritet, fushat e veprimit të programeve financiare të BE-së për Shqipërinë përgjatë procesit të anëtarësimit. Për të realizuar këtë studim u mbështetëm mbi dokumenta zyrtarë të Komisionit Evropian dhe institucioneve shqiptare. Nëpërmjet një analize sasore dhe cilësore u arrit në përfundimin se mbështetja financiare e BE-së ka ndihmuar proceset demokratizuese dhe integruese në Shqipëri. Ajo është shtrirë në fusha të ndryshme, ndihmat jepen në formë grantesh, fondet janë administruar në mënyrë të centralizuar nga Delegacioni i BE-së dhe shpesh ka munguar aftësia përrhithëse e institucioneve shqiptare.

Fjalë kyç: *Bashkim Evropian, Shqipëri, integrim, mbështetje financiare, anëtarësim*

Testimi ekstern dhe ndikimi i tij në rritjen e cilësisë në arsim

Dr. Ismail Kamberi

Universiteti Shtetëror i Tetovës

ismail.kamberi@unite.edu.mk

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim që t'i paraqesë përvojat ndëkombëtare të testimit ekstern në arsim, më konkretisht mënyrat e zbatimit të testimit ekstern në disa shtete perendimore dhe ballkanike. Në disa shtete aplikohet testimi ekstern pas diplommit siç është ai në Francë ku secili i diplomuar për t'iu punuar në shkolla, duhet të kalojë testimin ekstern nga komisioni shtetëror e pastaj të marrë titullin profesor (pedagog). Nuk është i njëjtë testimi ekstern në të gjitha shtetet. Universitetet aplikojnë mënyra të ndryshme të testimit ekstern siç janë: DCL, TOEIC, TOEFL, CLES 2, FCE, CAE, SSP, FTSR). Ky hulumtim merret me përvojat dhe analizat e sistemeve të ndryshme, standardet e shteteve perëndimore dhe mundësia e aplikimit në vendet e Ballkanit. Analiza e dytë merret me efikasitetin e testimit ekstern dhe mundësitë që ai të jetë objektiv dhe praktik. Gjithashtu analizohet vlerësimi formativ dhe ai sumativ i nxënësve. Ky hulumtim synon të zbulojë perceptimin e vlerësuar të profesorëve në lidhje me përmbushjen e këtij qëllimi të caktuar. Matja e perceptimeve të atyre që preken më drejtpërdrejt nga kjo politikë duhet të sigurojë një pamje të marrëdhënies midis qëllimit të vlerësimit të jashtëm të vendosur nga politikëbërësit dhe, përdoruesit e tij përfundimtar: profesorët dhe studentët. A është përmirësuar objektiviteti në vlerësimin e mësuesve? Cili është ndikimi i vlerësimit të jashtëm tek studentët? A e përmirëson testimi i jashtëm cilësinë e arsimit? Këto janë çështje që ende krijojnë mosmarrëveshje serioze në publik midis pjesëmarrësve kryesorë në arsim.

Fjalë kyç: *testim ekstern, rritja e cilësisë në arsim, efikasitet.*

Sfidat e universiteteve shqiptare gjatë harmonizimit me standardet europiane

Msc. Malvina Kosova

kosovamalvina@gmail.com

Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Kërkimi shkencor dhe inovacioni janë elementë thelbësorë të zhvillimit social dhe shoqëror të një vendi. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në Shqipëri (2008-2013) njeh këtë rol parësor të arsimit të lartë dhe synon reformimin e mëtejshëm të sistemit të arsimit të lartë për të qenë në përputhje me standardet europiane. Drafti i Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020) rikonfirmon këtë rol të arsimit të lartë dhe përcakton si prioritet cilësinë e arsimit të lartë; profilizimin e universiteteve sipas nevojave të zhvillimit të vendit dhe tregut të punës; rivlerësim i ndarjes së kostos së arsimit të lartë me studentët si dhe përmirësim i qeverisjes së brendshme të universiteteve duke kombinuar autonominë, përgjegjshmërinë me qeverisjen e mirë. Qëllimi i këtij artikulli është që të parashtrojë disa rekomandime për sfidat e arsimit të lartë në Shqipëri nën dritën e strategjisë EUROPA 2020. Gjithashtu, ky punim synon të kontribuojë në vazhdimin e debatit në sferën publike lidhur me reformimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Për të realizuar këtë analizë, ky artikull bazohet tek një qasje metodologjike cilësore të përdorimit të burimeve dytësore dhe intervistave të thelluara informuese me aktorë në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Fjalë kyç: *arsimi i lartë, standarde europiane, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, kërkim shkencor, inovacion.*

Kushtetutshmëria e masave qeveritare kundër pandemisë Covid-19 në Republikën e Kosovës

Ditar Kabashi, PhD. Cand.

Departamenti i të Drejtës Publike, Ankara HBV University
ditar.kabashi@hbv.edu.tr

Abstrakt

Krahas shfaqjes së krizave të paparashikuara shëndetësore, ekonomike, sociale e politike si rezultat i përhapjes së virusit SARS-CoV-19, një sfidë për shtetet u vu re të jetë edhe mungesa e infrastrukturës përkatëse ligjore për t'u ballafaquar me përmasat e një pandemie të këtillë. Nevoja e masave institucionale kundër pandemisë mund të jetë imediate për të ruajtur shëndetin publik, mirëpo kjo nuk parakupton që të injorohen rrugët procedurale juridike. Së këndejmi, ky punim nuk fokuset në vlerësimin e oportunitetit të vendimeve, por në vlerësimin e ligjshmërisë së tyre dhe kështu synohet që të vihen në pah zbrazëtitë ligjore dhe efektet juridike të masave qeveritare, gjithnjë duke përdorur metodat analitike dhe normative në kuadër të rendit juridik kosovar dhe metodën krahasimtare në raste të caktuara. Gjersa në shtetin e së drejtës duhen përcaktuar qartë rregullat për masat e ndërmarra dhe proporcionalitetin e tyre gjatë kohës sa nuk është shpallur zyrtarisht Gjendja e Jashtëzakonshme, disa vendime qeveritare në Kosovë përkitazi me masat antiCovid-19, ndonëse kishin për qëllim mbrojtjen e qytetarëve, janë cilësuar nga Gjykata Kushtetuese si të papajtueshme me Kushtetutën. Përfundimet në këtë trajtesë korrespondojnë në të gjeturat se "ruajtja e shëndetit" pranohet si një nga qëllimet legjitime mbi të cilën mund të kufizohen të drejtat e caktuara, porse gjithnjë duke respektuar kriterin e "përcaktimit në ligj" paraprakisht, në mënyrë që të shmanget çfarëdolloj probabiliteti për arbitraritet nga autoritetet shtetërore. Rrjedhimisht, konkluzionet janë lineare edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese.

Fjalë kyç: Covid-19, masa qeveritare, ruajtja e shëndetit, përcaktim ligjor, gjendja e jashtëzakonshme, Gjykata Kushtetuese.

Ndërhyrja euro-atlantike në krizën e Kosovës si nistare e proceseve euro-integruese të Ballkanit Perëndimor

Edval Zoto, MSc

Akademia e Studimeve Albanologjike (doktorant, Instituti i Historisë), Tiranë,
Shqipëri

email: edval.zoto@yahoo.com

Abstrakt

Shpërthimi i krizës humanitare në Kosovë, në përvijim të konfliktit të armatosur në vitet 1998-1999 u kthye menjëherë në një test për efikasitetin e politikës së jashtme europiane dhe një rast për të evidentuar përmirësimet e saj në fushën e administrimit të krizave rajonin ballkanik që nga konflikti i Bosnjë-Hercegovinës. Pakti i Stabilitetit do të përbënte një mekanizëm të fuqishëm për ruajtjen e paqes dhe frymës së bashkëpunimit në Ballkan si dhe tërheqjen e vendeve të Ballkanit drejt perspektivës së integritimit euroatlantik. Konflikti i armatosur në Kosovë ishte arsyeja kryesore e materializimit të kësaj iniciative madhore që u bë pikë kthese në historinë e marrëdhënieve midis vendeve ballkanike dhe Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë ishte e paprecedentë dhe unike në llojin e saj. Vendet e NATO-s ndërhynë në konfliktin serbo-shqitar pasi Kosova ishte shndërruar në një sfidë për humanizmin evropian si dhe formësimin e rendit të ri ndërkombëtar, i cili duhej të shpërbutej përfundimisht nga karakteristikat e trashëguara nga e shkuara. Ndërhyrja në Kosovë ripërcaktoi standardet e reja humanitare dhe gjithashtu vendosmërinë euroatlantike për përfshirjen e Ballkanit brenda familjes evropiane. Studimi synon të ofrojë një vështrim retrospektiv historik mbështetur në dokumentet e literaturën zyrtare të BE dhe NATO-s, si dhe identifikimin e elementëve përbashkues dhe përvijues me politikën e strategjitë aktuale në drejtim të integritimit të rajonit.

Fjalë kyç: *Integritimi evropian, Pakti i Stabilitetit, Konflikti në Kosovë, Bashkimi Evropian, Gjeopolitikë, NATO.*

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në përmbushjen e obligimeve të komunave në agjendën e integritetit në BE-konsultimet publike dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Iliriana Bajrami, PhD Candidate,

Universiteti i Evropës Juglindore, Email: ib29085@seeu.edu.mk

Florentina Hajdari Hajra, PhD Candidate

Universiteti i Evropës Juglindore, Email: fh29098@seeu.edu.mk

Abstrakt

Shteti i Kosovës ka bërë disa hapa konkrete në rrugëtimin drejt BE-së, ku rol të rëndësishëm ka qeverisja lokale me implementimin e kriterëve nga agjenda e integritetit. Është e qartë se një pjesë e madhe e obligimeve në implementimin e MSA-së është nën autoritetin dhe përgjegjësinë e komunave si nivel i parë i pushtetit ku qytetarët realizojnë pjesën më të madhe të drejtave dhe përgjegjësi të tyre. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë efektet e krijuara nga pandemia Covid-19 gjatë vitit 2020 në komunat e Kosovës, në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Vend të rëndësishëm ka analizimi i të dhënave zyrtare për komunat e Republikës së Kosovës, të cilat kanë përmbushur kriteret dhe detyrat nga agjenda evropiane për vitin 2020 me këtë përqindje; 57% kriteret politike, 65% kriteret ekonomike dhe 57 % standardet evropiane. Për më tepër, rezultatet e pyetësorit të dërguar nga tridhjetë e tetë (38) kryetarë të komunave, rezultojnë se shumica e komunave kanë ngecur në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, si pasojë e masave qeveritare për parandalim të përhapjes së pandemisë dhe rrjedhimisht komunat kanë dështuar të gjejnë forma alternative të konsultimit me qytetarë, duke mos konsideruar fare mundësinë e përdorimit të teknologjisë informative për të përmbushur këtë obligim ligjor.

Rezultatet e hulumtimit implikojnë se Republika e Kosovës duhet të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, të promovoj transparencën dhe llogaridhënien edhe përmes ndryshimeve ligjore, duke shqyrtuar përdorimin e alternativave bashkë-kohore, jo vetëm metodat tradicionale, me çka do të realizonte dhe zbatonte edhe një nder kërkesat dhe objektivat kryesore të Bashkimit Evropian në rrugën e integritetit të Kosovës në strukturat e BE-së.

Fjalë kyç: *Qeverisje lokale, Agjenda Evropiane, Bashkimi Evropian, konsultime publike.*

Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar nëpërmjet konfiskimit të pasurisë

Prof.Ass.Dr. Petrit Bushi

Kolegji AAB, Prishtinë
email: petrit.bushi@aab-edu.net

Abstrakt

Rritja e krimit të organizuar, trafikut të drogës, trafikimit me qeniet njerëzore, korrupsionit dhe ekonomia informale, kanë mundësuar fuqizimin e organizatave kriminale nga ana financiare. Përpyjekjet për dënimin e kriminelëve, qasja *in personam*, jo vetëm që nuk kanë patur sukses në luftën kundër krimit, por kanë sjellë dhe kosto të larta për organet ligjzbatuese. Qasja *in rem* është vlerësuar si më e suksesshme për dobësimin e financave të organizatave kriminale si dhe parandalimin e krimit. Qëllimi i këtij punimi është të njohë shkallën e zbatueshmërisë në fazën e hetimit, gjykimit dhe administrimit të aseteve kriminale si dhe efektet e zbatimit të ligjit për konfiskimin e zgjeruar në Republikën e Kosovës për periudhën 2013-2018. Mbledhja e të dhënave dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së ligjit për konfiskimin e zgjeruar në tri fazat e hetimit, gjykimit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara është bërë nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga ekspertët e fushës së hetimeve, gjykimeve dhe administrimit të pasurive dhe analizave të raporteve dhe statistikave të institucioneve përgjegjëse për këtë periudhë studimi. Rezultatet adresojnë ndryshime të domosdoshme në fushën legjislative, institucionale dhe kapaciteteve njerëzore për sa i përket konfiskimit të pasurisë kriminale, si dhe zgjerimin e veprave penale që shërbejnë si indicje për hetimin financiar.

Fjalë kyçe: konfiskim, kompetencat e zgjeruara të konfiskimit, vlera zëvendësuese.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

327(497:4)(062)

International Conference : The Perspective of
Integration of the Western Balkans into the EU : Book
of abstracts / AAB College. - Prishtinë : Kolegji AAB,
2021. – 68 f. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-494-98-4



ISBN 978-9951-494-98-4



9 789951 494984